

Nr. Prot
(Lutemi referoni këtë numër në përgjigje)

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik DIVITECH sh.p.k., Nipt L013060490. Adresa: “Rruga e Barrikadave”, Vila Nr. 222, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR. REF-08538-06-07-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Furnizim vendosje impiant i ri shpërndarës 6kV, përmirësimi i mbrojtjeve rele me sistem të monitorimit të qarkut të stakimit dhe integrimi i skemës së re në SCADA të HEC Koman”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 31, datë 18/06/2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1) Atom sh.p.k Nipt L22203042N, me ofertë ekonomike 114,670,000 (njëqind e katërbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
- 2) DIVITECH sh.p.k Nipt L013060490, me ofertë ekonomike 104,700,000 (njëqind e katërmilion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH.
- 3) Start CO sh.p.k, Nipt L11614001S, me ofertë ekonomike 107,990,000 (njëqind e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Start CO sh.p.k.:

1.OE Start CO sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.3. pasi në formularin përmbledhës të deklarimit për plotësim e këtij kriteri është deklaruar vetëm 1(një) inxhinier, ndërkohë që kriter kërkohen:

- Minimumi 2 (dy) Inxhinier Elektrik/Elektronik të çertifikuar nga prodhuesi/ institucione të autorizuara për sistemet e kontroll monitorimit (në përputhje me specifikimet teknike).
- Minimumi 2 (dy) Inxhinier Elektrik/Elektronik të çertifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuara për mbrojtjet rele.

2. OE Start CO sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.4 pasi kataloget e paraqitur në përmbushje këtij kriteri nuk përputhen me prodhuesin nga i cili është autorizuar OE.

3. OE Start CO sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.6 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Atom sh.p.k.:

1.OE Atom sh.p.k ka paraqitur ofertë ekonomike me të lartë se vlera e përlogaritur e fondit limit të kësaj kontrate.

2. OE Atom sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.1 pasi kontratat e paraqitura për plotësimin e këtij kriteri nuk janë të ngjajshme.

3. OE Atom sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.3. pasi nuk ka plotësuar në mënyrë të detajuar pikën B- Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), të shtojcës 9 – FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT. Nuk ka deklaruar në mënyrë të detajuar punonjësit/ profilet dhe certifikimet në përputhje me kriterin teknik të kërkuar.

4. OE Atom sh.p.k nuk plotëson kriterin kriterin 2.3.6 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik DIVITECH sh.p.k., Nipt L013060490. Adresa: “Rruga e Barrikadave”, Vila Nr. 222, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 104,700,000 (njëqind e katër milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare) Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (Tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Ankesat: **Jo,**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erald Elezi